



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA ROSKOVEC  
KRYETARI

Nr. 2565 Prot

Roskovec, më 03 . 04 .2025

VENDIM

Nr. 88 datë 03 . 04 .2025

“PËR  
AFISHIMIN E MATERIALEVE PROPAGANDISTIKE DHE EDUKATIVE  
GJATË FUSHATËS ZGJEDHORE, PËR ZGJEDHJET PËR KUVEND TË  
DATËS 11 MAJ 2025”

Në mbështetje dhe ligjit nr.139/2015 “Për vetqeverisjen vendore” ; neni 8, pika 2 ; të ligjit nr.10019 datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë i ndryshuar” neni 79 ; të ligjit 90/2017 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.8580 datë 17.02.2020 “Për partitë politike”; të ligjit Nr. 89/2022 “Për policinë bashkiake”; si dhe të Udhëzimit nr.6 datë 23.03.2021 “Për përdorimin e materialeve propagandistike e edukuese dhe rregullat për afishimin e tyre gjatë fushatës zgjedhore”,

Vendosa:

1. Gjatë periudhës së fushatës zgjedhore, lejohet përdorimi dhe afishimi i materialeve propagandistike në një distancë jo më të madhe se 5 metra larg zyrës elektorale të subjektit zgjedhor, jo më parë se 30 (tridhjetë) ditë para datës së zgjedhjeve.
2. Ndalohet afishimi i materialeve propagandistike në: fasadat e godinave të banimit, institucioneve publike apo ambienteve rrethuese pranë e rreth tyre, brenda zonave rekreative, parqeve, në pemët e qytetit dhe në shtyllat e ndriçimit.
3. Ndalohet afishimi i materialeve propagandistike në mjete që operojnë në transportin publik.
4. Te gjitha materialet propagandistike vizive qe perdoren ne fushate duhet te shoqerohen me shenimin: "Prodhuar nen pergjegjesine ligjore te ..... " (vijon emri i subjektit zgjedhor).



3. Të gjithë subjektet zgjedhore duhet të njoftojnë me shkrim për adresat e sakta të zyrave elektorale jo më vonë se 35 ditë para datës së zgjedhjeve. Brenda 5 (pesë) ditëve kryhet verifikimi i vendndodhjes së tyre në respektim të dispozitave të Udhëzimit nr.6 datë 23.03.2021 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, për afishimin dhe vendosjen e materialeve propagandistike.

4. Nëse materialet propagandistike të subjekteve zgjedhore vendosen në kundërshtim me këtë Vendim, Policia Bashkiake merr masa të menjëhershme për heqjen e tyre.

5. Pranë ambjenteve të Bashkisë Roskovec dhe Njësive Administrative Kuman, Kurjan dhe Strum lejohet afishimi i materiale edukative zgjedhore, në dispozicion të KQZ-së ose palëve të treta që nuk promovojnë fushatën e një subjekti të caktuar zgjedhor por që i shërbejnë edukimit të zgjedhësve lidhur me të drejtat e tyre dhe procedurat e regjistrimit dhe të votimit sipas Kodit Zgjedhor.

6. Një kopje e këtij Vendimi i dërgohet Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve menjëherë pas zbardhjes.

7. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen e internetit të Bashkisë Roskovec.

**KRYETAR**  
**Majlinda Buqi**

The image shows a circular official stamp of the Roskovec Municipality. The stamp contains the text 'REPUBLIKA E SHqipërisë' at the top, 'BASHKIA E ROSKOVEC' at the bottom, and 'KOMISIONI QENDRORE I ZGJEDHJEVE' in the center. Overlaid on the stamp is a large, stylized handwritten signature in blue ink.